



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26 Prill 2022

Nr: 149

V E N D I M

PËR

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË SHOYRTIMIT ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË ORGANIZATËS “QENDRESA QYTETARE” PËR SHKELJE TË PARASHIKUAR NË NENET 91 DHE 92 TË KODIT ZGJEDHOR DHE VENDIMIN NR. 9, DATË 24.12.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE NDAJ ZJ. ERISELDA SEFA, ZJ. OGERTA MANASTIRLIU MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, Z. PERIN VOGLI DREJTOR I SPITALIT “IHSAN ÇABEJ”, LUSHNJË DHE BASHKISË LUSHNJË

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N :

Referuar nenit 19, pika 1 shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Data: 26 Prill 2022

Nr. 149

“Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” për shkelje të parashikuar në nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Eriselda Sefa, zj. Ogerta Manastirliu, z. Perin Vogli Drejtor i Spitalit “Ihsan Çabej” Lushnjë dhe Bashkisë Lushnjë”



Referuar nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 09.04.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

- 1- Komisioneri fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në KQZ.
- 2- Afati që ka KQZ-ja për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.
- 3- Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Lidhur me denoncimin e Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj zj. Eriselda Sefa, zj. Ogerta Manastirliu Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, z. Perin Vogli Drejtor i Spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnjë dhe Bashkisë Lushnjë, nëpërmjet së cilit pretendohet se, “*Në datë 16.02.2022, në Spitalin e Lushnjës, konkretisht nën praninë e kandidatës së Partisë Socialiste të Shqipërisë, për kryetare të bashkisë Lushnjë, zj. Eriselda Sefa, e cila aktualisht mban postin e Kryetares në detyrë, drejtuesi politik i Partisë Socialiste për qarkun e Fierit, z. Taulant Balla dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zj. Ogerta Manastirliu, vizituan ambientet e Spitalit të Lushnjës me rastin e investimeve të zhvilluara në atë institucion spitalor*”, veprimtari e kryer në kundërshtim me nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOSI:

Data: 26 Prill 2022

Nr. 149

“Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” për shkelje të parashikuar në nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Eriselda Sefa, zj. Ogerta Manastirliu, z. Perin Vogli Drejtor i Spitalit “Ihsan Çabej” Lushnjë dhe Bashkisë Lushnjë”



1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, për shkelje të parashikuara në nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Eriselda Sefa, zj. Ogerta Manastirliu Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, z. Perin Vogli Drejtor i Spitalit “Ihsan Çabej”, Lushnjë dhe Bashkisë Lushnjë Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 26 Prill 2022

Nr. 149

“Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” për shkelje të parashikuar në nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Eriselda Sefa, zj. Ogerta Manastirliu, z. Perin Vogli Drejtor i Spitalit “Ihsan Çabej” Lushnjë dhe Bashkisë Lushnjë”